



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:128074
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637000

CAP.nr.1094/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit SH.SH nga Lipjani, të cilën me autorizimit e përfaqëson, av.E.G, nga Lipjani, ndaj debitorit Komuna e Lipjanit- Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale me seli në Lipjan, me objekt përmbartimi kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtëses së kreditorit SH.SH, av. E.G, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Dega në Lipjan, CP.nr.164/2023, i datës 09.06.2023, me datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit SH.SH nga Lipjani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan CP.nr.164/2023, i datës 09.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar CP.nr.164/2023, i datës 09.06.2023 ka vendosur si në vijim:

“I.REFUZOHET propozimi për lejimin e përmbartimit të kreditorit SH.SH nga Lipjani, ndaj debitorit Komuna e Lipjanit- Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale me seli në Lipjan, për shkak të papërshtatshmësisë së dokumentit përmbartimor.

II.OBLIGOHET Kreditorja, që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore për propozim të ia paguaj shumën prej 20.00,-€, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi, nën kërcenimin e përmbartimit të dhunshëm.”

Kundër këtij aktvendimi, ankesë ka paraqitur kreditorja SH.SH, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore dhe kontaktimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që të njëjtës ti lejohet përbarimi dhe të urdhërohet debitori Komuna e Lipjanit- Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, me seli në Lipjan, që kreditorit t'ia paguajë një pagë mujore në emër të shpërblimit jubilar.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 06.06.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit në bazë të titullit ekzekutiv - vendimit të Inspektoratit të Punës, i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, Nr. 01-14-192/2020, i datës 06.04.2020 më gjerësisht si në propozimin për përbarim.

Gjykata Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, me aktvendimin e atakuar CP.nr.164/2023, i datës 09.06.2023 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për lejimin e përbarimit, më konkretisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit për përbarim dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se propozimi për lejimin e përbarimit duhet të refuzohet si i pabazuar. Kjo për shkak se dokumenti në bazë të cilit është propozuar që të iniciohet procedura përbarimore konform nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tutje referuar si “Ligji për Procedurën Përbarimore”, edhe pse përbën titull ekzekutiv - dokument përbarimor, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përbarim. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se neni 27, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Përbarimore shprehimisht përcakton se: dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të janë treguar kreditori, debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.” Mbi këtë bazë, është e qartë se në mënyrë që një dokument përbarimor të jetë i përshtatshëm për përbarim, duhet që në mënyrë kumulative të plotësoj të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore dhe atë pa asnjë përjashtim.Rrjedhimisht, bazuar në kërkesën ligjore të lartpërmendur, dokumenti përbarues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përbarimit në rastin konkret është i pa përshtatshëm për përbarim. Kjo sepse në dispozitivin e vendimit, përkatësisht dokumentit përbarimor nuk është përcaktuar shuma të cilën debitori i përbarimit duhet ta përmbushë ndaj kreditorit të përbarimit por vetëm në mënyrë të

përgjithësuar është obliguar punëdhënësi t'ia paguajë kreditorit 1 pagë mujore, në emër të shpërblimit jubilar për vitet e shërbimit si Infermiere në QKMF-Lipjan.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata e shkallës së parë në rastin konkret, ka konstatuar se dokumenti përbarimor me të cilin është iniciuar procedura përbarimore në këtë çështje juridike, konkretisht Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01-14-192/2020 të dt. 06.04.2020, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh, të bëjë kompensimin në emër të një page mujore shumë prej 377.00 Euro, megjithëse paraqet dokument përbarimor, i njëjti, konform nenit 27 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, nuk është i përshtatshëm për përbarim, sepse në këtë procedurë përbarimore vlerësohet vetëm dokumenti mbi të cilin lejohet përbarimi që në këtë rast është vendimi i lartcekur i IP-së, i cili nuk e përcakton shumën në dispozitiv lidhur kërkesën që ka propozuar kreditori për ta ekzekutuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe Gjykata ankimore i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit gjatë shikimit të shkresave të lëndës, vëren se dokumenti në bazë të së cilit është bërë propozimi për përbarim është vendim i inspektoratit të punës dhe se si i tillë parashihet si dokument përbarimor, për shkak se LPP-së vendimet e organit administrativ i njeh si dokumente përbarimore, mirëpo përkundër këtij fakti edhe kjo Gjykatë vlerëson se nuk janë përmbushur të gjitha elementet e përcaktuara me dispozita ligjore që të lejohet përbarimi i dokumentit në fjalë.

Neni 27 i LPP-së, në mënyrë shprehimore parasheh se “*dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bën dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim.

Nga shikimi i shkresave të lëndës, për këtë Gjykatë rezulton të provohet fakti se dokumenti përbarimor –vendimi administrativ i Inspektoriatit të Punës, Nr. 01-14-192/2020, i datës 06.04.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nënkupton se dokumenti në fjalë nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për tu përbaruar sepse është në kundërshtim me dispozitata e LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1094/2023, me datën 29.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.